



RRJETI I
SHËRBIMEVE
SOCIO-SHËNDETËSORE

● Bashkia Shkodër

RRJETI I
SHËRBIMEVE
SOCIO-SHËNDETËSORE


Bashkia **Shkodër**

Informacioni u mblodh nga:

Organizata “Consulting and Development Partners”



Hartimi dhe publikimi i këtij dokumenti u realizua me mbështetjen e Projektit “Shëndet për të Gjithë” të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC”



**Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC**



Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	5
Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Shkodër	6
Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor	10
Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik në Bashki	12
Bashkia Shkodër	14
Qendrat Komunitare për Familjen	
Qendrat Ditore për të Moshuarit, Nr. 1 dhe Nr. 4	18
Shtëpia e të Moshuarve	20
Qendra Rezidenciale për të Moshuarit	22
“Te Zotnitë”	
Qendra Rezidenciale për të Moshuarit	24
“Anna Lappini”	
Organizata Shqiptare e Urdhrit të Maltës	26
Shërbim socio-shëndetësor për të Moshuarit	
Madonnina della Grappa	28
Shtëpia Familje për Persona me Aftësi Ndryshe	
Madonina della Grappa	30
Shërbim Fizioterapie për personat në nevojë	
Shoqata Islamic Relief, Shkodër	32
Shërbimi për të moshuarit dhe të sëmurët kronikë	
Shoqata Islamic Relief, Shkodër	34
“Në ndihmë të fëmijëve jetimë”	
Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Shkodër	36
Fondacioni FIRDEUS	38
Rezidenca për të Moshuarit “Si në Shtëpi”	
Gruaja tek Gruaja	40
Strehëza e Emergjencës për Rastet e Dhunës	
Gruaja tek Gruaja	42
Shërbime për gratë dhe vajzat viktime të dhunës	
Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë”	44

Hyrje

Rrjeti i Shërbimeve Socio-Shëndetësore në Bashkinë Shkodër është një nismë e mbështetur nga Projekti “Shëndet për të Gjithë” i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në zbatim të “Strategjisë Kombëtare të Kujdesit Shëndetësor Parësor” 2020-2025. Dokumenti synon të fuqizojë shërbimin socio-shëndetësor në Kujdesin Shëndetësor Parësor (KSHP), përmes përmirësimit të qasjes dhe cilësisë së shërbimeve sociale, veçanërisht të atyre që synojnë arritjen e popullatave të cënueshme.

Ky dokument përbën një mjet pune që u vjen në ndihmë punonjësve socialë pranë KSHP-së për të lidhur ose referuar pacientët drejt shërbimeve plotësuese, që nuk mund të ofrohen nga Qendrat Shëndetësore. Njëkohësisht, ky dokument u vjen në ndihmë aktorëve të tjerë lokalë të shërbimeve sociale dhe shëndetësore, si Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik në Bashki, Shërbimi Social Shtetëror Rajonal dhe Organizatat e Shoqërisë Civile në Bashkinë Shkodër, duke u mundësuar njohjen dhe koordinimin më të mirë të shërbimeve në zonën e tyre të mbulimit.

Rrjeti i Shërbimeve Shëndetësore dhe Sociale në Bashkinë Shkodër u përgatit nga Organizata “Consulting and Development Partners” Shkodër gjatë periudhës Nëntor – Dhjetor 2023.

Për realizimin e këtij dokumenti, falendërojmë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik në Bashki, Shërbimin Social Shtetëror Rajonal dhe Organizatat e Shoqërisë Civile në Bashkinë Shkodër, si bashkëpunëtorë të rëndësishëm në jetësimin e këtij procesi.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Shkodër

Lloji i institucionit	Publik
Adresa	Lagjja: "Qemal Stafa", Rruga "Zogu i Parë" Email: drejtoriasshshshkoder@yahoo.com
Përfaqësues ligjor i institucionit	Valbona Tula Cel.: 00355 67 39 57429 Email: valbona.tula@sherbimisocial.gov.al
Personi i kontaktit	Valbona Tula
Mbulimi gjeografik	Rajonal (5 Bashki: Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz)
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 1993

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- Qëllimi i shërbimit**
 - Rritja e cilësisë së jetës për personat vulnerabël në rajonin Shkodër
- Fushat e shërbimeve**
 - Shërbime shoqërore (Institucione të Përkujdesjes Sociale)
 - Shërbime të pagesave për Ndihmë Ekonomike dhe Aftësinë e Kufizuar
- Llojet e shërbimeve**
 - Shërbime shoqërore (Institucione të Përkujdesjes Sociale):**
 - Monitorim të standardeve të shërbimeve sociale në rajon të ofruara nga Institucionet e Përkujdesjes Sociale, publike dhe jopublike, rezidenciale dhe ditore që ofrojnë shërbime për fëmijë (të trafikuar, me probleme social-ekonomike), të rritur (me probleme social-ekonomike), persona 65+, gra të dhunuara;
 - Administrim të Regjistrimit Elektronik për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror (përfshirë dosjet e të moshuarve për azil);
 - Shërbime të pagesave për Ndihmë Ekonomike dhe Aftësinë e Kufizuar:**
 - Programim dhe detajim të fondeve të ndihmës ekonomike (shqyrton dosjet e përfituesve);
 - Programim dhe detajim të fondeve të pagesës për personat me aftësi të kufizuar (shqyrton dosjet e përfituesve);
 - Shpërndarja e bonusit të foshnjës.

Shërbimet e monitoruara nga DRSHSSH Shkodër

Shërbime Sociale për Fëmijë

- Shërbime Rezidenciale për Fëmijë (4 qendra)
- Shërbime Ditore për Fëmijë (8 qendra)
- Ditore & Rezidenciale (1 qendër)

Shërbime Sociale për të Moshuar

- Shërbime Rezidenciale për të Moshuar (3 qendra)
- Shërbime Ditore për të Moshuar (1 qendër)

Shërbime për Persona me Aftësi të Kufizuar

- Shërbime Rezidenciale për PAK (3 qendra)
- Shërbime Ditore për PAK (2 qendra)
- Ditore & Rezidenciale (1 qendër)

Shërbime Sociale për Gra të Dhunuara/Viktima Trafikimi

- Shërbime Ditore
- Shërbime Rezidenciale dhe Shërbime të tjera Komunitare

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Familjet
- Personat me aftësi të kufizuar
- Të moshuarit
- Gratë e dhunuara/viktimat e trafikimit

Kriteret kualifikuese

Për fëmijët:

- Jetimët që nuk janë në institucione
- Fëmijët e vendosur në shërbimin e kujdestarisë

Për përfituesit e ndihmës ekonomike:

- Kryefamiljarët
- Të papunët
- Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme

Për përfituesit e pagesës së Aftësisë së Kufizuar:

- Paraplegjikët ose tetraplegjikët
- Personat me aftësi të kufizuar ose të paaftë për punë
- Invalidët e punës
- Personat rezidentë në qarkun e Shkodrës

Për të moshuarit:

- Të moshuarit 65+
- Të vetmuarit
- Personat që nuk zotërojnë pasuri të paluajtshme (tokë, shtëpi)

Për gra të dhunuara/viktima të trafikimit:

- Viktimat e trafikimit, në periudhën pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;
- Viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes;
- Përmes shërbimeve publike të përkujdesjes dhe mbështetjes sociale në rajon

Identifikimi i përfituesve

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- 15 punonjës

Financuesi i shërbimit

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Burime të tjera të ardhurash

- Kontributet nga donacione e sponsorizime

Pagesa nga përfituesit

- Nuk ka

Koordinimi me shërbime të tjera

- Drejtoria e Kujdesit Social në pesë Bashkitë e qarkut Shkodër;
- Njësitë Administrative për përfituesit e ndihmës ekonomike;
- Mjekët e familjes dhe specialistët për skemën e Aftësisë së Kufizuar;
- Inspektoriat i Punës;
- Organizata ndërkombëtare dhe lokale në fuqizim të komuniteteve.

Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor

Lloji i institucionit	Publik
Adresa	Rruga "Wilson", Lagjja Vasil Shanto, Poliklinika e Specialiteteve, Shkodër
Përfaqësues ligjor i institucionit	Dr. Gjon Preci Cel.: 00355 69 20 73075 Email: precigjon@gmail.com
Personi i kontaktit	Dr. Gjon Preci Cel.: 00355 69 20 73075 Email: precigjon@gmail.com
Mbulimi gjeografik	Rajonal (Bashkia Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë)
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 2010

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- Qëllimi i shërbimit**
 - Përmirësimi i mirëqenies emocionale, psikologjike dhe sociale për personat që kanë probleme të shëndetit mendor dhe komunitetin në tërësi
- Fushat e shërbimeve**
 - Shërbim shëndetësor
 - Shërbim social
 - Shërbim psikologjik
 - Shërbime parandaluese, edukuese dhe promovim shëndetësor
- Llojet e shërbimeve**
 - Shërbime shëndetësore**
 - Diagnostikim dhe trajtim mjekësor i sëmundjeve mendore;
 - Ndjekje të rastit dhe menaxhim të medikamenteve;
 - Rekomandime për ekzaminime apo ndjekje të mëtejshme;
 - Terapi infermierore në qendër, banesë dhe shtëpitë psikiatrike (kryesisht injeksione, mjekime);
 - Vlerësim multidisiplinor bio-psiko-social (bashkë me psikologun dhe punonjësin social);
 - Mbështetje e katër shtëpive psikiatrike me shërbime shëndetësore (shtëpitë psikiatrike si formë e deinstitutionalizimit në shëndetin mendor).
 - Shërbime sociale**
 - Mbështetje në përgatitjen e dokumentacionit për procedurat e kempit (KMCAP);
 - Shoqërimi i pacienit në konsulta të tjera mjekësore;
 - Ndërlidhës me shërbime të tjera sipas nevojave;

Shërbime psikologjike

- ↳ Vlerësime dhe raporte psikologjike;
- ↳ Ofrimi i seancave të psikoterapisë;
- ↳ Këshillim për menaxhimin e sëmundjes kronike;
- ↳ Mbështetje psikologjike dhe edukim mbi sëmundjen mendore për familjarët;

Shërbime parandaluese:

- ↳ Parandalim përmes edukimit shëndetësor individual, në grup dhe komunitet.

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- ↳ Gjithë komuniteti

Kriteret kualifikuese

- ↳ Çdo anëtar i komunitetit me çrregullime të shëndetit mendor;
- ↳ Çdo anëtar i komunitetit në nevojë për informim, edukim, dhe parandalim të çrregullimeve mendore.

Identifikimi i përfituesve

- ↳ Përmes sistemit publik shëndetësor të referimit

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- ↳ 13 punonjës

Financuesi i shërbimit

- ↳ Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale

Burime të tjera të ardhurash

- ↳ Nuk ka

Pagesa nga përfituesit

- ↳ Nuk ka

Koordinimi me shërbime të tjera

- ↳ Kujdesi Shëndetësor Parësor, përmes qendrave shëndetësore
- ↳ Spitali Psikiatrik dhe ai Rajonal Shkodër
- ↳ Drejtoria e Kujdesit Social Bashkia Shkodër
- ↳ Njësitë Administrative të bashkive
- ↳ Policia e Shtetit
- ↳ Shkollat dhe komuniteti

○ Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik në Bashki

Lloji i institucionit Publik

Adresa Rruga 13 Dhjetori, Nd. 9, H. 1, Shkodër
Email: info@bashkiashkoder.gov.al

Përfaqësues ligjor i institucionit **Arlinda Kruja, Drejtor**
Email: arlinda.kruja@bashkiashkoder.gov.al

Personi i kontaktit **Arlinda Kruja, Drejtor**
Email: arlinda.kruja@bashkiashkoder.gov.al

Mbulimi gjeografik Bashkia Shkodër (Njësitë Administrative Velipojë, Dajç, Bërdicë, Ana e Malit, Gur i Zi, Postrinë, Rrethinë, Shosh, Pult, Shalë)

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2016

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

○ **Qëllimi i shërbimit** ➤ Përmirësimi i cilësisë së jetës për grupet vulnerabël në Bashkinë Shkodër

○ **Fushat e shërbimeve** ➤ Administrim dhe Koordinim i Shërbimeve Sociale
➤ Shërbime strehimi
➤ Shërbime koordinimi të shërbimeve, kryesisht sociale në Bashkinë Shkodër

○ **Llojet e shërbimeve** **Administrim dhe Koordinim i Shërbimeve Sociale:**
➤ Administrim i 9 Qendrave Komunitare për Familjen (Informacion i detajuar në Fishën “Qendrat Komunitare për Familjen”)
➤ Administrim i 2 Qendrave Ditore për të Moshuarit (Rajoni 1 & 4, informacion i detajuar në Fishën “Qendrat ditore për të moshuarit”)
➤ Administrim i Qendrës Multifunksionale për kategoritë vulnerabël
➤ Koordinim i Shërbimit të Urgjencës për rastet e dhunës në familje
➤ Koordinim i shërbimeve sociale në Bashkinë Shkodër

Shërbime strehimi:

➤ Shërbime strehimi për të pastrehët sipas Ligjit Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”; i ndryshuar (VKM 384, datë 12.06.2019)

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
 - ↘ Familjet
 - ↘ Gratë
 - ↘ Fëmijët
 - ↘ Të moshuarit
- Kriteret kualifikuese**
 - ↘ Persona që janë të pajisur me urdhër mbrojtjeje;
 - ↘ Gratë dhe vajzat në vështirësi socio-ekonomike, viktime të dhunës në familje, etj.;
 - ↘ Personat 65+
 - ↘ Familjet në nevojë për Strehim Social në bazë të vlerësimit sipas ligjit;
 - ↘ Familjet në vështirësi sociale dhe ekonomike;
 - ↘ Fëmijët në konflikt me ligjin, në situatë rruge, etj.;
- Identifikimi i përfituesve**
 - ↘ Përmes Institucioneve publike lokale (institucionet koordinuese të listuara më poshtë)

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
 - ↘ 32 punonjës
- Financuesi i shërbimit**
 - ↘ Bashkia Shkodër
 - ↘ Buxheti i Shtetit
- Burime të tjera të ardhurash**
 - ↘ Donatorët e huaj
 - ↘ Organizata joqeveritare përmes zbatimit të projekteve lokale
- Pagesa nga përfituesit**
 - ↘ Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - ↘ Institucionet publike lokale, Bashkia dhe Njësitë Administrative
 - ↘ Shërbimet lokale nën juridiksionin e Bashkisë Shkodër
 - ↘ Policia e Shtetit/Gjykata/Prokuroria
 - ↘ Qendrat Shëndetësore dhe Spitali Rajonal Shkodër
 - ↘ Zyra Vendore Arsimore
 - ↘ Zyra e Punës
 - ↘ Organizata joqeveritare
 - ↘ Komuniteti.

O Bashkia Shkodër

Qendrat Komunitare për Familjen

Lloji i institucionit Publik

Adresa Qendra Komunitare për familjen nr. 1. Lagjja Kiras, Shkodër
Qendra Komunitare për familjen nr. 2. Rruga “Nazmi Kryeziu”, nr. 48
Qendra Komunitare për familjen nr. 3. Rruga “Marin Becikemi”
Qendra Komunitare për familjen nr. 4. Rruga “Jorgji Karamitri”, Shkodër
Qendra Komunitare për familjen nr. 5. Lagjja Marlula, Rruga 7 Shaljanët
Qendra Komunitare për familjen Postrribë. Fshati Mes, Postrribë
Qendra Komunitare për familjen Gur i Zi. Fshati Gur i Zi, Njësia Administrative Gur i Zi
Qendra Komunitare për familjen Rrethina. Fshati Shtoj i Vjetër, Njësia Administrative Rrethina
Qendra Komunitare për familjen Dajç, fshati Mushan, Njësia administrative Dajç

Përfaqësues ligjor i institucionit **Arlinda Kruja,**
Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik
Email: arlinda.kruja@bashkiashkoder.gov.al

Personi i kontaktit **Ditjola Salja,** Rajoni 1
Cel.: 00 355 67 30 62 656 | Email: Ditjola.Salja@sherbimisocial.gov.al
Alma Mujaxhi, Rajoni 2
Cel.: 00355 69 47 74 433 | Email: almamujaxhi@gmail.com
Aferdita Alija, Rajoni 3
Cel.:00355 69 94 93 380 | Email: aferditaalija1996@gmail.com
Stesi Gjonaj, Rajoni 4
Cel.: 00355 67 62 26 502 | Email: gjonajstesi@gmail.com
Xhoelda Shelqetja, Rajoni 5
Cel.: 00355 69 62 84 343 | Email: xhoelda.sh@gmail.com
Bujar Bajraktaraj, Nj. Ad Postrribe
Cel.: 00355 67 63 58 044 | Email: bujarbajraktari28@outlook.com
Arjet Rahova, Nj. Ad Rrethina
Cel.: 00355 69 67 72 399 | Email: arjetfood@gmail.com
Flaudora Lukaj, Nj. Ad Dajç
Cel.: 00355 67 32 24 166 | Email: flaudoralukaj@gmail.com
Enxhi Vasa, Nj. Ad. Gur i Zi
Cel.: 00355 69 30 79 669 | Email: enxhivasa18@gmail.com

Mbulimi gjeografik Bashkia Shkodër

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2016

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit

- Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit

Fushat e shërbimeve

- Shërbim për mbrojtjen e fëmijëve
- Shërbim për familjet
- Shërbime ditore për gratë e dhunuara
- Shërbime ditore për të moshuar
- Shërbime të edukimit shëndetësor në shkolla dhe qendër

Llojet e shërbimeve

Shërbime për mbrojtjen e fëmijëve:

- Vlerësimi i gjendjes social-ekonomike, nevojave dhe mundësive për integrim, asistencë për qasje në kurse profesionale, asistim në polici për fëmijët në konflikt me ligjin;
- Koordinimi i Grupit Teknik Ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, hartimi dhe monitorimi i plan-ndërhyrjes;
- Monitorimi i situatës së fëmijëve në situatë rruge;

Shërbime për familjet:

- Vlerësim socio-ekonomik për akomodim në institucionet rezidenciale, publike ose private të individëve në nevojë;
- Vlerësim i nevojave socio-ekonomike, këshillim dhe orientim për punësim, ndërlidhje me shërbime të tjera;
- Asistencë administrative për aplikim pranë zyrave ekonomike, të punës apo shërbime të tjera;
- Monitorim i urdhrave të mbrojtjes për personat e dhunuar - ndërlidhje me shërbime të tjera;

Shërbime ditore për gratë e dhunuara:

- Këshillim dhe mbështetje psiko-emocionale për vajzat dhe gratë subjekte të dhunës në familje/me bazë gjinore;
- Orientim/informim/këshillim ligjor (mbi divorcin, kujdestarinë e fëmijëve);
- Ndjekje ligjore të çështjeve/seancave gjyqësore;
- Aktivitete edukative, sociale dhe rekreative për gratë;
- Angazhim të vajzave dhe grave në Qendra për trajnime profesionale;

Shërbime ditore për të moshuar:

- Qendrat komunitare ditore për të moshuarit, Rajoni 1 dhe Rajoni 4
- Shërbime të edukimit shëndetësor në shkolla dhe qendër:
- Edukim dhe promovim shëndetësor në shkolla dhe qendër.

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
 - ↳ Fëmijët
 - ↳ Familjet
 - ↳ Gratë
 - ↳ Të moshuarit
 - ↳ Komuniteti
- Kriteret kualifikuese**
 - ↳ Fëmijët deri në 18 vjeç;
 - ↳ Familjet në vështirësi ekonomike;
 - ↳ Familjet me persona me aftësi të kufizuara;
 - ↳ Vajza dhe gra me probleme të dhunës në familje/me bazë gjinore, përjashtimit, diskriminimit;
 - ↳ Nëna në proces divorci dhe me të ardhura të ulëta apo pa të ardhura;
 - ↳ Të moshuar 65+
- Identifikimi i përfituesve**
 - ↳ Referimi i rasteve nga institucione publike lokale
 - ↳ Organizata jofitimprurëse/Komuniteti

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
 - ↳ 1-2 persona në çdo qendër
- Financuesi i shërbimit**
 - ↳ Bashkia Shkodër
- Burime të tjera të ardhurash**
 - ↳ Donatorë të huaj
- Pagesa nga përfituesit**
 - ↳ Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - ↳ Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashki
 - ↳ Shërbimi Social Shtetëror Rajonal, Shkodër
 - ↳ Zyra e Ndihmës Ekonomike/ Zyra e Punës
 - ↳ Zyra Vendore Arsimore, Shkollat e Rajonit
 - ↳ Shërbimi shëndetësor parësor dhe spitalor
 - ↳ Organizatat jofitimprurëse

○ Qendrat Ditore për të Moshuarit, Nr. 1 dhe Nr. 4

Qendrat ditore për të moshuarit administrohen nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik në Bashkinë Shkodër. Fisha përmban informacion për Qendrën nr. 1 (Xixëllonjat) dhe Qendrën nr. 4, me gamë të njëjtë shërbimesh, por zona të ndryshme mbulimi.

Lloji i institucionit Publik

Adresa Qendra nr. 1: Lagjja Kiras, Shkodër
Qendra nr. 4: Rruga "Jorgji Karamitri", Shkodër

Përfaqësues ligjor i institucionit **Arlinda Kruja**
Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik
Email: arlinda.kruja@bashkiashkoder.gov.al






Personi i kontaktit **Ditjola Salja**
Qendra Ditore për të Moshuarit nr. 1
Cel.: 00355 67 30 62656 | Email: Ditjola.Salja@sherbimisocial.gov.al

Stesi Borici
Qendra Ditore për të Moshuarit nr. 4
Cel.: 00355 67 62 26502 | Email: gjonajstesi@gmail.com |
Email: stesi.gjonaj@sherbimisocial.gov.al

Mbulimi gjeografik Rajoni 1 dhe 4 në Bashkinë Shkodër

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2016

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit**  Zbutja e problemeve psiko-sociale dhe shmangia e izolimit social për të moshuarit në qytetin e Shkodrës
- **Fushat e shërbimeve**  Shërbime ditore psiko-sociale
 Shërbime shëndetësore
- **Llojet e shërbimeve** Shërbime ditore psiko-sociale:
 -  Shërbime sociale ditore për të moshuarit (socializim përmes aktiviteteve ditore me dhe për të moshuarit);
 -  Biseda individuale apo në grup me synim mbështetjen psikologjike të të moshuarve;

Shërbime shëndetësore:

- ↘ Ofrimi i shërbimeve shëndetësore (matje të glicemisë dhe tensionit arterial);
- ↘ Edukim dhe promovim shëndetësor për shëndetin dhe higjienën tek të moshuarit;

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese** ↘ Persona 65+
- Kriteret kualifikuese** ↘ Të moshuar që jetojnë në lagjet nr. 1 dhe 4
↘ Të moshuar të vetmuar
↘ Të moshuar në vështirësi social-ekonomike
- Identifikimi i përfituesve** ↘ Përmes stafit të qendrave dhe punës së tyre në terren
↘ Përmes institucioneve referuese
↘ Përmes komunitetit

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve** ↘ 2 persona në çdo qendër
- Financuesi i shërbimit** ↘ Bashkia Shkodër
↘ UNDP (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim)
- Burime të tjera të ardhurash** ↘ Nuk ka
- Pagesa nga përfituesit** ↘ Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera** ↘ Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Shkodër
↘ Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Shëndetësor Parësor
↘ Bashkia Shkodër
↘ Organizata të tjera lokale joqeveritare

O Shtëpia e të Moshuarve

Lloji i institucionit Publik

Adresa Lagjja "Jorgji Karamitri", Nr. 23, Shkodër

Përfaqësues ligjor i institucionit **Fatjon Hoxha**

Cel.: 00355 67 36 07666 | Email: fatjon.hoxha@sherbimisocial.gov.al

Personi i kontaktit **Mirsada Rroji**

Cel.: 00355 69 32 95091 | Email: mirsada.abdurrahmani@hotmail.com

Mbulimi gjeografik Kombëtar

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 1948

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit

➤ Mundësimi i një jetese dinjitoze për të moshuarit

Fushat e shërbimeve

- Shërbime shëndetësore dhe infermierore në rezidencë
- Shërbime psikosociale në rezidencë
- Shërbime rezidenciale për të moshuarit

Llojet e shërbimeve

Shërbime shëndetësore dhe infermierore në rezidencë

- Monitorim i gjendjes shëndetësore të të moshuarve;
- Konsulta nga Mjeku i Përgjithshëm për të moshuarit rezidentë, rekomandime për te specialisti, analiza dhe ekzaminime të tjera, përshkrim recete, etj.;
- Monitorim i sëmundjeve kronike, injeksione, dhënia e medikamenteve, mjekim të plagëve, marrje gjaku për analiza, etj. nga infermierja e rezidencës;
- Shoqërimi i të moshuarve në spital, sipas nevojës;

Shërbime psiko-sociale

- Mbështetje emocionale dhe psikologjike sipas nevojave;
- Këshillim për të moshuarit si të përballojnë moshimin, etj.;
- Biseda dhe diskutime individuale apo në grup për shqetësime të moshës, socializimit, etj.;
- Aktivitete socializuese dhe argëtuese për rezidentët;
- Shoqërim për nevoja jashtë institucionit, rinovim i dokumentave, etj.;
- Respektim i momentit të fundit, shërbime funerale.

Shërbime rezidenciale për të moshuarit

- Rezidencë për të moshuarit (ushqim, fjetje, kujdes higjieno-sanitar për të moshuarit)

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
 - ↳ Persona 65+
- Kriteret kualifikuese**
 - ↳ Të moshuar me aftësi të kufizuara
 - ↳ Të moshuar të paaftë për t'u kujdesur për veten
 - ↳ Të moshuar të vetmuar, pa përkujdesje të familjarëve
 - ↳ Të moshuar pa strehim
 - ↳ Të moshuar pa mundësi financiare për përkujdesje
- Identifikimi i përfituesve**
 - ↳ Shërbimi Social në Bashki
 - ↳ Shërbimi Social Shtetëror Rajonal

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
 - ↳ 28 punonjës
- Financuesi i shërbimit**
 - ↳ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Burime të tjera të ardhurash**
 - ↳ Bashkia Shkodër
 - ↳ Organizata dhe Donatorë sipas projekteve
 - ↳ Bizneset
- Pagesa nga përfituesit**
 - ↳ 40 % e pensionit paguhet nga çdo përfitues për shërbimin
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - ↳ Shërbimi Social i bashkisë
 - ↳ Shërbimi Social Shtetëror Rajonal
 - ↳ Shërbimin shëndetësor parësor dhe spitalor
 - ↳ Instituti i Sigurimeve Shoqërore
 - ↳ Organizata jofitimprurëse/Komuniteti

Qendra Rezidenciale për të Moshuarit “Te Zotnitë”

Lloji i institucionit Privat

Adresa Rruga: “Revolucioni Antikomunist Hungarez”, Shkodër
Cel.: 00355 67 30 81079 | Email: alma_kurti@yahoo.it

Përfaqësues ligjor i institucionit **Alma Kurti**
Cel.: 00355 67 30 81079 | Email: alma_kurti@yahoo.it

Personi i kontaktit **Alma Kurti**
Cel.: 00355 67 30 81079 | Email: alma_kurti@yahoo.it

Mbulimi gjeografik Kombëtar

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2003

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit

➤ Mundësimi i një jetese dinjitoze për të moshuarit

Fushat e shërbimeve

- Shërbime rezidenciale për të moshuarit
- Shërbime shëndetësore dhe infermierore në rezidencë
- Shërbime psikosociale në rezidencë

Llojet e shërbimeve

Shërbime rezidenciale për të moshuarit

➤ Rezidencë për të moshuarit (ushqim, fjetje, kujdes higjieno-sanitar për të moshuarit)

Shërbime shëndetësore dhe infermierore në rezidencë

- Monitorim i gjendjes shëndetësore të të moshuarve;
- Konsulta nga Mjeku i Përgjithshëm për të moshuarit rezidentë, rekomandime për te specialisti, analiza dhe ekzaminime të tjera, përshkrim recete, etj.;
- Monitorim i sëmundjeve kronike, injeksione, mjekim të plagëve, marrje gjaku për analiza, etj. nga infermierja e rezidencës;

Shërbime psikosociale

- Mbështetje emocionale dhe psikologjike sipas nevojave;
- Këshillim për të moshuarit si të përballojnë moshimin, etj.;
- Biseda dhe diskutime individuale apo në grup për shqetësime të moshës, socializimit, etj.;
- Aktivitete socializuese dhe argëtuese për rezidentët.

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
 - ↳ Të moshuarit
- Kriteret kualifikuese**
 - ↳ Persona 60+
 - ↳ Të përballojnë koston e shërbimit
 - ↳ Të mos jenë të sëmurë terminalë
 - ↳ Të mos ketë situatë shëndetsore të komplikuar që kërkon përkujdesje përtej atyre që ofron qendra shëndetësore
- Identifikimi i përdoruesve**
 - ↳ Nga komuniteti dhe të interesuarit

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
 - ↳ 11 punonjës
- Financuesi i shërbimit**
 - ↳ Shërbim privat
- Burime të tjera të ardhurash**
 - ↳ Jo
- Pagesa nga përfituesit**
 - ↳ 60.000 lekë pagesë mujore
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - ↳ Shërbimi Social në Bashkinë Shkodër
 - ↳ Shërbimi Social Shtetëror Rajonal
 - ↳ Organizata të tjera private dhe/ose jofitimprurëse
 - ↳ Komuniteti

Qendra Rezidenciale për të Moshuarit “Anna Lappini”

Lloji i institucionit Privat

Adresa Rruga “Ernest Koliqi”, Shirokë, Shkodër

Përfaqësues ligjor i institucionit **Dukata Radoja**
Cel.: 00355 68 23 68600 | Email: d.radoja@hotmail.com

Personi i kontaktit **Motër Marjana Ndreca**
Cel.: 00355 67 36 81119

Mbulimi gjeografik Kombëtar

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2022

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit

➤ Mundësimi i një jetese dinjitoze për të moshuarit

Fushat e shërbimeve

- Shërbime rezidenciale për të moshuarit
- Shërbime shëndetësore dhe infermierore në rezidencë
- Shërbime psikosociale në rezidencë

Llojet e shërbimeve

Shërbime rezidenciale për të moshuarit
➤ Rezidencë për të moshuarit (ushqim, fjetje, kujdes higjieno-sanitar)

Shërbime shëndetësore dhe infermierore në rezidencë

- Monitorim i gjendjes shëndetësore të të moshuarve;
- Konsulta nga Mjeku Kardiolog për të moshuarit rezidentë, rekomandime për te specialisti, analiza dhe ekzaminime të tjera, përshkrim recete, etj.;
- Monitorim i sëmundjeve kronike, injeksione, mjekim të plagëve, marrje gjaku për analiza, etj. nga infermierja e rezidencës;
- Fizioterapi për rezidentët.

Shërbime psikosociale

- Mbështetje emocionale dhe psikologjike sipas nevojave;
- Këshillim për të moshuarit si të përballojnë moshimin, etj.;
- Biseda dhe diskutime individuale apo në grup për shqetësime të moshës, socializimit, etj.;
- Aktivitete socializuese dhe argëtuese për rezidentët;
- Shërbim shpirtëror për rezidentët.

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese** ➤ Personat 60+
- Kriteret kualifikuese**
 - Persona 60+
 - Të moshuar autonomë
 - Të moshuar me autonomi të kufizuar (pagesë më e lartë)
 - Të përballojnë koston e shërbimit
 - Të mos jenë të sëmurë terminalë
 - Të mos kenë probleme të shëndetit mendor
- Identifikimi i përdoruesve**
 - Kisha Katolike
 - Promocion në televizione lokale
 - Komunitet
 - Bashkia Shkodër
 - Shërbimi Social Shtetëror Rajonal
 - Organizata jofitimprurëse/Caritas

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve** ➤ 11 punonjës
- Financuesi i shërbimit** ➤ Pagesat e përfituesve për shërbim
- Burime të tjera të ardhurash** ➤ Organizata bamirëse/Donatorë
- Pagesa nga përfituesit**
 - Të moshuarit autonomë, 350 euro/muaj
 - Të moshuarit jo autonomë, 450 euro/muaj
 - Të moshuarit e varfër, pensionin e tyre
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - Partnerët për identifikim të përfituesve
 - Urdhri “Motrat Stigmatine të Shën Françeskut”

Organizata Shqiptare e Urdhrit të Maltës

Shërbim socio-shëndetësor për të Moshuarit

Lloji i institucionit	Organizatë joqeveritare
Adresa	Rruga “Ludovik Saraçi”, Nr. 59, 4001, Shkodër Cel.: 00355 68 20 80207 info@malteser.al www.malteser.al
Përfaqësues ligjor i institucionit	Raisa Bekteshi, Shkoder Email: raisa.bekteshi@malteser.al
Personi i kontaktit	Raisa Bekteshi, Shkoder Email: raisa.bekteshi@malteser.al
Mbulimi gjeografik	Bashkia Shkodër, Bashkia Lezhë, Bashkia Vau Dejës
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 1995

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- Qëllimi i shërbimit**
 - Mirëqënie dhe dinjitet për të moshuarit
- Fushat e shërbimeve**
 - Shërbim shëndetësor
 - Shërbim psiko-social
- Llojet e shërbimeve**
 - Shërbime shëndetësore**
 - Asistencë shëndetësore në qendër dhe në familje (monitorim dhe mbarëvajtje të sëmundshmërisë, matje të parametrave vitale, etj.);
